

**VENDIM**  
**Nr. 389, datë 30.5.2012**

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË FINANCIVE PËR PËRDORIMIN E FONDEVE NGA LLOGARIA E SHPRONËSIMEVE PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT NR. 44, DATË 17.3.2011 TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR PUKË, ME OBJEKT “KTHIM SHUME NGA SHPRONËSIMI, SI DHE DËMSHPËRBLIM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2 të aktit normativ nr. 6, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr. 10 190, datë 4.12.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autorizimin e Ministrisë së Financave, të përdorë fondin nga llogaria e shpronësimeve për interesa publikë për likuidimin e detyrimeve nga zbatimi pjesor i vlerës së vendimit civil nr. 44, datë 17.3.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në favor të kreditorëve “Pjetër Lula e të tjerë, përfaqësuar me prokurë nga Ndue Marashi”, me objekt “Kthim shume nga shpronësimi, si dhe dëmshpërblim”, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe për të gjitha shpenzimet gjyqësore e tarifën përmbartimore.

2. Ekzekutimi i këtij vendimi bëhet nga Ministria e Financave, nëpërmjet zyrës së përmbartimit.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi për shumën 52 272 721 (pesëdhjetë e dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e njëzet e një) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave për shpronësimet, në Bankën e Shqipërisë, ndërsa shpenzimet gjyqësore për shumën 1 038 350 (një milion e tridhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë, si dhe tarifa përmbartimore përkatëse të përballohen nga shpenzimet korente të Ministrisë së Financave.

4. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**